



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Datë: 14.10.2022, Gjiçan

Në pajtim me nenin 32 paragrafi 4, nenet 79, 80 dhe 81 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 8 dhe 10 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimit administrative (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorit Publik, shpall:

SHPLLJE E REKRUTIMIT

Titulli i vendit të punës:	Përfaqësues Ligjor i Komunës
Institucioni:	Komuna e Gjiçanit
Departamenti/ Drejtoria:	Zyra e Kryetarit
Lloji i pozitës:	Niveli profesional 1
Numri i pozitave:	(1) një
Titulli i mbikëqyresit:	Kryetari i Komunës
Grada/Kofeficienti:	9.5
Lloji i emërimit:	Në kohë të caktuar (jo më gjatë se 12 muaj)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Ofron mbrojtje ligjore të Komunës
2. Përfaqëson dhe mbron interesin e Komunës në të gjitha procedurat gjyqësore e administrative në instanca të ndryshme;
3. Ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror e juridik të Komunës në përputhje me përgjegjësitë e tija të përcaktuara me ligj;
4. Bashkëpunon me udhëheqësit e drejtorive dhe zyrtarët Komunal në gjetjen dhe paraqitjen e fakteve për prezantim sa më të mirë të Komunës para organeve gjyqësore, administrative dhe organeve tjera shtetërore;
5. Kërkon nga organet kompetente Komunale që ti ofrojnë dokumente-dëshmi për lëndët gjyqësore dhe administrative që mund të jenë objekt i shqyrtimit gjyqësor ose janë në procedura të ndryshme gjyqësore;
6. Ushtron mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike ndaj vendimeve gjyqësore dhe administrative;
7. Harton shkresa të ndryshme lidhur me lëndët gjyqësore dhe të njëjtat ua dërgon organeve kompetente dhe palëve në procedurë;
8. Kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin e aktet nënligjore dhe autorizimet e marra nga punëdhënësi si përfaqësues ligjor Komunës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor).
- Kualifikimi: Fakulteti juridik
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale
- Të ketë njohuri lidhur me procedurat standarde në fushën gjyqësore dhe administrative;
- Aftësi për të punuar me vetë-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar normat juridike;
- Shkathtësi kompjuterike në programet (Word, Excel, etj);

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i komplettoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje) si vijon:

1. Dëshmi të kualifikimit shkollorë, fotokopje e noterizuar
2. Dëshmi mbi përvojën e punës
3. Dokumentin e identifikimit
4. Çertifikatën se nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale
5. Çertifikatën mjekësore (**Për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs, në fund të procedurës rekrutuese e njëjta do të kërkohet vetëm nga kandidati më i suksesshëm**)

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 14.11.2022 deri me 28.11.2022.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve ose në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me shkrim përmes Ueb faqes zyrtare të komunës dhe tabelës së shpalljeve publike të Komunës.

Dokumentet e pranuar të aplikantëve fotokopje, nuk kthehen.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>